



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 359 Prot.

Tiranë, më 28 / 02 / 2020

V E N D I M

Nr. 25, Datë 28 / 02 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 114 Regj., datë 16.09.2019, e E. P, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*gjendjes ekonomike*”, “*përgjegjësisë prindërore*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes martesore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, E. P, ka qenë në marrëdhënie pune me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) që prej datës 01.12.2003 deri në datën 15.08.2019. E. P shprehet se gjatë gjithë periudhës që ka qenë i punësuar pranë DPD, punëdhënësi i ka ndryshuar shumë herë pozicionin e punës, pa miratimin e tij, duke e emëruar në detyra të ndryshme, si psh. “jurist” ndërkohë që arsimimi i tij është “inxhinier”, gjë të cilën ai e ka pranuar dhe nuk e ka kundërshtuar për shkak të nevojës për punë. Ai vijon duke cituar se, prezenca e tij dhe e gjithë grupit të punës ka qenë e monitoruar në çdo ditë pune gjatë gjithë vitit, duke theksuar se: “*Për shkak të natyrës së punës, kur konstatoheshin shkelje në degë të ndryshme doganore, unë dhe gjithë grupi që drejtoja, për mbylljen e procedurave ishim të detyruar të rrinim me orë të zgjatura deri në orët e vona të ditës për plotësimin e formularëve, raportimin e shkeljes dhe përgatitjen e dosjes për organet e*

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

prokurorisë. Të gjitha këto procedura në shumicën e rasteve janë bërë jashtë orarit zyrtar dhe prej më shumë se 3 muajve nuk jam paguar as me dieta”.

Z.P shpjegon se gjatë vitit 2019, DPD ka ndërmarrë ndaj tij dy masa disiplinore të njëpasnjëshme, për të cilat pretendon se janë tendencioze, pa procedurë ligjore dhe të panjoftuara, duke specifikuar, konkretisht:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.362 prot., datë 08.01.2019 i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me motivacionin e mos realizimit të objektivave të vendosura, mos raportimit në mënyrë periodike, kontrollit të munguar kundrejt inspektorëve, mosrespektimit të orarit të punës, duke iu referuar muajit Dhjetor 2018. Ankuesi shprehet se periudha e dhënies së kësaj mase disiplinore, përkon me humbjen e një personi të afërt, nënës së tij, duke specifikuar se me datë 15.12.2018 ajo ka ndërruar jetë për shkak të një trompoze, pas disa ditëve qëndrimi në spitalin nr.5 Tiranë. (Ankuesi i ka bashkëlidhur ankesës njoftimin dhe çertifikatën e vdekjes të së ndjerës). Ndërsa, ka sqaruar lidhur me marrjen e kësaj mase disiplinore se ai nuk është thirrur asnjëherë dhe nuk i është njoftuar asnjëherë kjo masë dhe se ka marrë dijeni për këtë të fundit me datë 22.08.2019² në momentin që ka aplikuar për t’u pajisur me dosjen personale nga Burimet Njerëzore të DPD-së.

Nga ana tjetër, kjo masë disiplinore është dhënë duke u referuar në dispozitat e Kodit të Punës³, ndërkohë që subjekti ankues deri në datën 14.06.2019, gëzonte statusin e Nëpunësit Civil⁴.

2. Nëpërmjet shkresës me nr.9663 prot., datë 16.04.2019 i është dhënë masa e dytë disiplinore “Vërejtje me shkrim”, për mosprezencë në vendin e punës, në orën 14:00 të datës 09.04.2019, për të cilën z.P shprehet se është totalisht arbitrare, duke shpjeguar se, ai dhe grupi i tij i punës kishin detyrim të kontrollonin avionin e linjës ajrore Turkish Airline, i cili arrinte në orën 17:00. Ankuesi shpjegon se, meqenëse nuk kishte avion në atë orar, në orën 13:30 ai dhe i gjithë grupi i punës janë larguar për drekë, gjë për të cilën ata kanë njoftuar qendrën duke specifikuar se do të ktheheshin në orën 17:00, kohë në të cilën do të ulej avioni i linjës ajrore Turkish Airline, për të cilin ishin urdhëruar të bënin kontroll. Kjo ditë përkon dhe më një ngjarje shumë të rëndë të ndodhur në aeroportin e Rinasit (grabitje me armë në pistën e avionëve), si shkak i së cilës Policia e Shtetit kufizoi lëvizjen e mjeteve nga ora 14:30 deri në orën 18:30, duke pamundësuar kështu ushtrimin e kontrollit në momentin e mbërritjes së grupit të punës në aeroport.

Z.P, ka sqaruar lidhur me marrjen e kësaj mase të dytë disiplinore se ai nuk është thirrur dhe nuk i është njoftuar kjo masë dhe se sërish ka marrë dijeni për këtë të fundit me datë 22.08.2019⁵ në momentin që ka aplikuar për t’u pajisur me dosjen personale nga Burimet Njerëzore të DPD-së.

Ai shprehet se në momentin që ka marrë dijeni për masat disiplinore, me datë 22.08.2019, ka përgatitur dhe ka paraqitur observacionin e tij lidhur me vërejtjet, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga DPD.

² Referuar shkresës me nr.21335/1 prot., datë 22.08.2019 të Departamentit Administrativ të DPD.

³ Referuar shkresës me nr.13627/1 prot., datë 14.06.2019 të DPD.

⁴ Referuar shkresës me nr.362 prot., datë 08.01.2019 të DPD.

⁵ Referuar shkresës me nr.21335/1 prot., datë 22.08.2019 të Departamentit Administrativ të DPD.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Lidhur me vërejtjen e dhënë nëpërmjet shkresës me nr.9663 prot., datë 16.04.2019, për mosprezencë në vendin e punës, në orën 10:43 të datës 10.04.2019, ankuesi sqaron se atë ditë, referuar Grafikut të Shërbimeve, ai ka qenë pushim. Me datë 10.04.2019, në aeroportin e Rinasit ka qenë një grup tjetër i antikontrabandës që drejtohej nga Komandanti B.R.

Lidhur me sa mësipër, subjekti ankues shprehet se të dyja vërejtjet me shkrim i janë dhënë në periudhën që ai gëzonte statusin e Nëpunësit Civil, i cili i është hequr me datë 14.06.2019, për shkak të funksionit si kryetar i grupit të antikontrabandës dhe nuk kanë lidhje me marrëdhënien e re të punës, rregulluar me Kontratën e Punës të datës 31.05.2019. Ai citon se zgjidhja e Kontratës së Punës është bërë me vendim të Komitetit Disiplinor të DPD, i cili është ngritur në zbatim të ligjit “Për Nëpunësin Civil”, ndërkohë që marrëdhënia e punës është rregulluar me Kod Pune.

Z.P pretendon se diskriminimi ndaj tij ka vijuar që në muajin Dhjetor 2018, duke cituar kronologjinë e ndëshkimeve administrative, si më poshtë:

-heqjen e statusit si Nëpunës Civil,

-dhënien e dy vërejtjeve me shkrim,

-detyrimin për të raportuar disa herë në ditë,

-kërkimin e fotove në çdo rast, për të gjithë grupin, krejt ndryshe nga grupet e tjera të antikontrabandës (ankuesi ka bashkëlidhur disa komunikime me sms mes tij dhe Zyrës së Monitorimit në DPD).

Ankuesi pretendon se diskriminimi ndaj tij, ka ardhur për shkaqet e pretenduara ⁶, dhe se ai ka detyrime financiare ndaj dy fëmijëve të cilët jetojnë me ish-bashkëshorten e tij, të cilat nuk arrin t’i përmbushë që në momentin që DPD ka zgjidhur marrëdhëniet e punës me të.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit dhe rregullimin e pasojave.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁷, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

⁶ Cituar në paragrafin e parë, faqja e parë e vendimit.

⁷Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr.1377/2 prot., datë 27.09.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues DPD, lidhur me pretendimin e ankuesit.
2. Nëpërmjet shkresës me nr.24490/5 prot, datë 18.10.2019, DPD ka dërguar parashtrimet e veta dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar, duke argumentuar se:

“Z.P është transferuar në pozicionin “Jurist Borxhi” në Degën Doganore Morinë në datën 21.10.2014–05.05.2015 dhe lidhur me këtë fakt nuk ka depozituar asnjë ankesë pranë institucionit. Në përfundim të afatit të komandimit ai është transferuar në pozicionin “Komandant Grupi” në Drejtorinë e Antikontrabandës”.

Lidhur me procedurën e ndjekur për dhënien e masave disiplinore ndaj tij, DPD ka informuar KMD se:

- Nëpërmjet shkresës me nr.362 prot., datë 08.01.2019, i është dhënë masa e parë disiplinore “Vërejtje me shkrim” me motivacionin e mosrealizimit të objektivave të vendosura, mos respektimit të orarit të punës, etj, në përmbushje të Rregullores së Brendshme të DPD.
- Nëpërmjet shkresës me nr.9663 prot., datë 16.04.2019 i është dhënë masa e dytë disiplinore “Vërejtje me shkrim”, bazuar në informacionin e ardhur nga Sektori i Monitorimit DIARM, lidhur me kontrollet e ushtruara për datat 09,10,11 Prill 2019.

DPD është shprehur se z.P nuk i ka kundërshtuar masat disiplinore sipërcituar.

Lidhur me kontestimin e legjitimitetit të Komisionit Disiplinor të DPD nga ana e ankuesit, DPD ka parashtruar se:

“Komisioni Disiplinor (KD) pranë DPD është ngritur⁸ në zbatim të VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në KD në Shërbimin Civil, VKM nr.921, datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, Udhëzimit nr.1, datë 02.04.2014 të DAP “Elementët kryesorë proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”. Po ashtu DPD nëpërmjet Urdhërit nr.17146 prot., datë 01.07.2019 “Për procedurën disiplinore për personelin e Administratës Doganore jashtë Shërbimit Civil” ka ngritur Komisionin për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore ndaj punonjësve të Administratës Doganore, të cilët nuk përfshiheshin në Shërbimin Civil”.

DPD ka sqaruar se KD apo eprori direkt për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, bazohet në:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
- b) shkallën e fajësisë dhe,
- c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se nuk janë realizuar pagesat e dietave dhe urdhërave të shërbimit, DPD ka dërguar bashkëlidhur dokumentacionin provues që këto pagesa janë realizuar prej saj.

Lidhur me dhënien e masave disiplinore ndaj ankuesit, DPD shpjegon se:

“Masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” me nr.362 prot., datë 08.01.2019 është dhënë bazuar në Relacionin nr.29141 prot., datë 11.12.2018 të Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD. Në vijim, është dhënë e njëjta masë disiplinore për të gjithë komandantët dhe grupet e punës të cilët janë konstatuar përgjegjës sipas këtij raporti.

Po ashtu, e njëjta masë disiplinore “Vërejtje me shkrim”, më datë 16.04.2019 është dhënë për të gjithë pjesëtarët e grupit të punës. Në vijim, Vendimi “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës” është mbështetur në Relativimin e KD pranë DPD⁹ si dhe shkeljet e detyrimeve kontraktuale në mënyrë të përsëritur nga z.P, konstatime të mungesave të vazhdueshme të tij në vendin e punës, të cilat nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, të kërkohet vazhdimi i marrëdhënieve të punës”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se vetëm ndaj tij dhe grupit të tij të punës është kërkuar dërgimi i fotove nga vendi i punës, DPD ka informuar se:

“Pretendimi i z.P se ka njoftuar Qendrën, nuk qëndron. Asnjë nga kontrollet apo kërkimi i fotove, për të treguar nëse janë apo jo grupet në vendin e shërbimit, nuk janë tendencioze por kontrole rutinë që bëhen çdo ditë për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të punës. Nëse eprori ka informacion se një grup i caktuar nuk është në vendin e shërbimit, mund t'i kërkojë edhe foto vetëm atij grupi për të vërtetuar prezencën ose jo të tyre. Në rastin konkret, nga informacioni i datës 09.04.2019 nga Sektori i Monitorimit është provuar (pranuar dhe nga z.P) se ai nuk ka qenë prezent”.

⁸ Nëpërmjet Urdhërit nr.7099/2 prot., datë 17.11.2017 “Për krijimin e Komisionit të përhershëm Disiplinor pranë DPD”.

⁹ Shkresa me nr.18101/3 prot., datë 30.07.2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së E. P, Komisioneri me datë 16.12.2019¹⁰ realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Në seancë u paraqit subjekti ankues personalisht së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor, av.E.K¹¹, me nr.Liçence 1069, lëshuar nga Dhoma e Avokatisë. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e DPD nuk u paraqit asnjë përfaqësues i këtij institucioni.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr.87 prot., datë 17.01.2020 subjekti ankues ka depozituar në cilësi prove, kopje të biletave të prenotuara dhe paguara prej tij, gjatë tre viteve të fundit (2016-2019) në emër të të birit, S.P, i cili jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me nënën e tij.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) për rreth 16 vite: nga data 20.02.1998 deri në datën 26.08.1999 dhe ka rifilluar marrëdhëniet e punës sërisht me datë 01.12.2003 deri në datën 15.08.2019, datë në të cilën i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, nëpërmjet vendimit “Për zgjidhjen e menjehershme të kontratës së punës”.

Rezulton e provuar se, gjatë marrëdhënieve të punës me DPD ankuesi ka punuar në detyra të ndryshme, duke renditur sipas kronologjisë kohore :

- Me datë 27.11.2003 E. P është emëruar në detyrën e Specialistit të Doganës në Drejtorinë Rajonale Tiranë, pozicion të cilin ai e ka mbajtur deri në datën 03.06.2005, kur është emëruar në detyrën e Shefit të Turnit në Degën e Doganës Qaf-Thanë Pogradec.
- Me datë 02.08.2006 subjekti ankues është emëruar në detyrën e Shefit të Turnit dhe Përgjegjës të Pikës Doganore Qaf-Thanë.
- Me datë 31.03.2009 z.P është emëruar në detyrën e Doganierit të Klasifikimit/Vlerësimit/Kontrollit Fizik në Degën e Doganës Qaf-Thanë.
- Me datë 28.07.2009 z.P është transferuar dhe emëruar në detyrën e Përgjegjës të Zyrës Pranim/Peshoreje/Pikë Kontrolli në Degën e Doganës Tiranë.
- Me datë 18.09.2013 është komanduar deri në një urdhër të dytë në Degën e Doganës Morinë, në detyrën Jurist Borxhi, detyrë që e ka mbajtur deri në datën 21.10.2014 kur është transferuar në detyrën Specialist Investimesh në Sektorin e Investimeve dhe Logjistikës në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

¹⁰ Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr.1377/4 prot., datë 10.12.2019, të Komisionerit.

¹¹ Identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit me nr.personal G 85823034 J.

- Njëpërmjet Urdhërit “Për transferim të përkohshëm në detyrë”, datë 22.05.2015, z.P është transferuar në detyrën Inspektor Antikontrabande në Sektorin e Antikontrabandës Tokësore pranë Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rekuperimit me Forcë të Borxhit.
- Njëpërmjet Urdhërit “Për transferim të përkohshëm në detyrë”, datë 15.02.2016, z.P është transferuar në detyrën Komandant Grupi Antikontrabande Tokësore, në Drejtorinë e Antikontrabandës dhe Rekuperimit me Forcë të Borxhit, pranë DPD dhe me datë 21.07.2016 është emëruar në këtë detyrë. Këtë detyrë ankuesi e ka mbajtur deri në datën 15.08.2019, datë në të cilën i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Nga sa shihet më lart, ankuesi është transferuar disa herë duke u emëruar në detyra/pozicione të ndryshme pune, që nga lidhja e marrëdhënieve të punës me DPD.

a) Lidhur me pretendimin e z.P se është diskriminuar për sa i takon transferimeve të herëpashërshme të tij dhe konkretisht emërimit si Jurist Borxhi, Komisioneri vlerëson se ky pretendim i tij nuk mund t’i nënshtrohet procedurës hetimore pasi:

- Komandimi i ankuesit në detyrën Jurist Borxhi në Degën e Doganës Morinë, është bërë me datë 18.09.2013, ndërsa ankesa është regjistruar pranë KMD-së me datë 16.09.2019, rreth gjashtë vite pasi ka ndodhur procesi i transferimit/komandimit, pra më vonë se një vit nga marrja dijani.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt*”, pretendimi i ankuesit lidhur me transferimin/komandimin e tij, nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se janë tejkaluara afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin dhe shqyrtimin e kësaj pjesë të ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. .

b) Lidhur me momentin e largimit të ankuesit nga puna dhe procedurës disiplinore të ndjekur nga ana e DPD, Komisioneri vëren se:

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune me DPD për periudhën 2003-2019. Deri në momentin e largimit nga puna, ankuesi ka mbajtur detyrën Komandant Grupi Antikontrabande Tokësore, në Drejtorinë e Antikontrabandës dhe Rekuperimit me Forcë të Borxhit, pranë DPD.

Njëpërmjet shkresës me nr.18101/3 prot., datë 30.07.2019 Komisioni Disiplinor (KD) i DPD ka propozuar ndaj subjekti ankues masën disiplinore “Largim nga detyra”.

Në vijim të propozimit të KD, me Vendimin “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës” datë 15.08.2018, DPD ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me ankuesin.

Në vlerësim të tërësisë së dokumentacionit të administruar dhe legjislacionit përkatës, Komisioneri konstaton se, procedimi disiplinor ndaj ankuesit është bërë në shkelje flagrante të procedurës së përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë procedurën e ndjekur nga ky Komisioni Disiplinor dhe punëdhënësi, për dhënien e masës disiplinore për largimin nga puna për ankuesin, gjë që e bën atë një akt të paligjshëm.

Shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurës të procedimit disiplinor ndaj ankuesit, kanë të bëjnë me masat disiplinore të ndërmarra, gjë që ka pasqyruar dhe largimin e tij përfundimtar nga puna. Kështu:

- Nëpërmjet shkresës me nr.362 prot., datë 08.01.2019 të DPD, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me motivacionin e mosrealizimit të objektivave të vendosura, mosraportim në mënyrë periodike, kontroll i munguar kundrejt inspektorëve, mosrespektim i orarit të punës.

Lidhur me masën e parë disiplinore, DPD ka vënë në dispozicion vetëm shkresën me nr. 362 prot., datë 08.01.2019 të DPD “Vërejtje me shkrim” dhe Relacionin nr.29141 prot., datë 11.12.2018 të Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD.

- Ndërkaq, vërehet se z.P është njohur me masën disiplinore sa më sipër, pas rreth 7-muajsh, në momentin që i është komunikuar nga Institucioni me datë 22.08.2019.
- Ai nuk ka patur dijeni më përpara dhe aq më tepër të ishte njohur me të dhe të kishte patur mundësinë ta kundërshtonte atë.
- Nëpërmjet shkresës me nr.21335 prot., datë 21.08.2019, ankuesi ka paraqitur një kërkesë drejtuar DPD për vënien në dispozicion të dosjes së tij personale.
- Nëpërmjet shkresës me nr.21335/1 prot., datë 22.08.2019 DPD ka vënë në dispozicion të ankuesit kopjen e dosjes së tij personale, datë në të cilën ankuesi ka rënë në dijeni për herë të parë për këtë vërejtje.
- DPD nuk provoi që ankuesi të ishte njoftuar lidhur me masën disiplinore dhe që atij t’i ishin vënë në dispozicion provat bashkëlidhur, apo që t’i ishin krijuar mundësitë për t’u dëgjuar dhe mbrojtur ndaj saj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Pë.r mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar nenin 10, të tij: *“Organi publik*

siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Kodi i Procedurës Administrative¹² dhe Kodi i Punës, i ndryshuar¹³, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/subjektit ndaj të cilit paraqitet ankesa, në këtë rast DPD, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Referuar barrës së provës sikurse është cituar dhe më lart në vendim, DPD duhet të provonte që procedura e ndjekur për dhënien e kësaj mase disiplinore ishte e ligjshme dhe konform përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore.

Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, Komisioneri gjykon se nga ana e DPD është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e DPD.

Lidhur me masën e dytë disiplinore, Komisioneri vëren se, sa i takon me dhënies së kësaj mase disiplinore, nuk do të merret me analizimin e *“shkeljes së pretenduar”* në vetvehte, pasi edhe në këtë rast, për analogji, është e njëjta llogjikë si në rastin e dhënies së masës së parë disiplinore.

Subjekti ankues është njohur me këtë masë disiplinore vetëm me datë 22.08.2019, pas kërkesës së tij pranë DPD për t’u pajisur me kopjen e dosjes personale.

Pra, nga ana e DPD është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e DPD.

Nisur nga kronologjia e fakteve dhe rrethanave, citojmë se Komisioneri ka konstatuar një sërë parregullsish të tjera proceduriale, të cilat afektojnë në thelb dhe substancën e kësaj mase disiplinore:

¹²Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

¹³Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Së pari, subjekti ankues nëpërmjet shkresës me nr.3304/719 prot., datë 30.10.2014 të Departamentit të Administratës Publike (DAP) “Akt deklarimi i statusit të punësimit” ka përfituar statusin e nëpunësit civil.

Së dyti, masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” e datës 16.04.2019 i është dhënë ankuesit nga Drejtori i Antikontrabandës, eprori i tij direkt, duke referuar në pjesën hyrëse të saj, kryesisht dispozitat ligjore të Kodit të Punës, të ndryshuar. Por, duke qenë se ankuesi është trajtuar me statusin e nëpunësit civil deri me datë 14.06.2019, datë kur i është hequr ky status për shkak të funksionit si Kryetar i Grupit të Antikontrabandës, atij nuk mund t’i jepej masa disiplinore nga vetë eprori direkt i tij, pasi, marrëdhënia e punës mes ankuesit dhe DPD nuk rregullohej me Kod Punë aktualisht, dhe për më tepër, edhe në të kundërt; Drejtori mund të bëjë vetëm propozimin për dhënie të masës disiplinore ndaj vartësit të tij, ankuesit në rastin konkret, por në asnjë rast nuk mund të marrë atributet e punëdhënësit, titullarit të DPD. Një parashikim i tillë, në terma të përgjithshëm përcaktohet në nenin 37¹⁴, të Kodit të Punës. Një fakt i tillë evidentohet edhe nga korrespondenca zyrtare ndërmjet vetë strukturave të DPD. Kështu:

- Me shkresën me nr. 9663 prot., datë 16.04.2019 “Për dhënie mase disiplinore” ndaj z.P, Drejtori i Antikontrabandës, eprori direkt i tij, ka njoftuar dhe ngarkuar për zbatim Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DPD për zbatimin e masës disiplinore.
- Në vijim të shkresës së mësipërme, me shkresën me nr.10440 prot., datë 25.04.2019 Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ka informuar Drejtorinë e Antikontrabandës, se shkresa ka parregullsi dhe mosrespektim të procedurave disiplinore referuar legjislacionit në fuqi për nëpunësit/punonjësit, duke cituar se: *“Për dhënien e masës disiplinore në cilësinë e eprorit direkt duhet ndjekur procedura sipas përcaktimeve ligjore të Udhëzimit nr.1, datë 02.04.2014. Në rast të paraqitjes së propozimeve për ecurinë disiplinore pas shqyrtimit të ri administrativ, të merren masa që akti administrativ që shoqëron praktikën të ketë formën dhe arsyetimin e aktit në përputhje me nenin 99 dhe 100 të Kodit të Procedurës Administrative”*.

Nga sa sipërcitohet, evidentohet në mënyrë të qartë se dhënia e masës disiplinore nga ana e Drejtorit të Antikontrabandës është bërë pa respektuar asnjë procedurë ligjore dhe për më tepër në tejkallim të kompetencave ligjore të Drejtorit të Antikontrabandës, duke e bërë masën në vetvehte një akt nul.

- Nëpërmjet shkresës me nr.10440/1 prot., datë 11.06.2019 Drejtori i Antikontrabandës, informon Drejtorinë e Antikontrabandës se në zbatim të rekomandimit të saj, do të vazhdojë procedurën për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore për z.P.
- Ndërkaq, tre ditë më pas, me vendimin nr.13627/1 prot., datë 14.06.2019 të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, “Për lirimin nga shërbimi civil”, z.P i ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil, në pozicionin Komandant Grupi i sektorit të Antikontrabandës Tokësore në Drejtorinë e Antikontrabandës, pranë DPD, me arsyetimin se: *“Duke qenë se E. P përfshihet në strukturat, nëpunësit e të cilëve sipas ligjit*

¹⁴ Masat disiplinore.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

realizojnë/kanë atributet e agjentit/oficerit të policisë gjyqësore dhe lejohen të mbajnë armë dhe si të tillë janë të përjashtura shprehimisht nga fusha e veprimit të këtij ligji”.

Lidhur me masën e tretë disiplinore, propozimin “Për largim nga detyra” të KD, dhe Vendimin “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”, të DPD, Komisioneri ka shqyrtuar procedurën e ndjekur dhe shkeljen e pretenduar, duke vlerësuar se:

- Së pari, ka parregullsi dhe mosrespektim të procedurave disiplinore referuar legjislacionit në fuqi për nëpunësit/punonjësit.

Megjithëse në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore, nëpërmjet Urdhërit nr.17146 prot., datë 01.07.2019 është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore ndaj punonjësve të Administratës Doganore të cilët nuk përfshihen në shërbimin civil në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi dhe përbërja e tij është konform kërkesave të akteve përkatëse ligjore; në pikën 4, të tij ka shkelje të së drejtës së subjektit ndaj së cilit prezumohet të iniciojë ecuria disiplinore, pasi në kundërshtim me parashikimet që bën VKM nr.961, datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore” ngushton afatin që ai (subjekti) ka për t’u njohur dhe përgatitur lidhur me aktet mbi të cilat është iniciuar dhe ecuria e tij disiplinore.

Kështu, pika 4 e këtij Urdhri ka përcaktuar se: “*KD e fton punonjës të japë shpjegimet me shkrim brenda 5(pesë) ditëve pune nga e nesërmja e njoftimit të tij për aktet e ecurisë disiplinore...gjithashtu siguron kushte për njohjen dhe marrjen e akteve të dosjes”.*

Theksojmë se, VKM nr.961, datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, në kreun VI “Procedura disiplinore dhe Komisioni Disiplinor”, në pikën 21 ka përcaktuar se:

“KD e fton nëpunësin civil apo punonjës të administrativ të japë shpjegimet me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga e nesërmja e njoftimit të tij për ecurinë disiplinore”.

Nga këqyrja e akteve shkresore të dosjes së ankuesit, konstatohet se njoftimi për zhvillimin e seancës dëgjimore, z.P i është komunikuar me datë 17.07.2019, duke e njoftuar se: “*Në datën 23.07.2019, ora 11:30 pranë Zyrës së Zv/Drejtorit të Përgjithshëm Administrativ, do të zhvillohet seanca dëgjimore në Komisionin Disiplinor”.* Pra, nga sa shihet qartë, me një përlllogaritje të thjeshtë matematikore, nuk janë respektuar nga ana e KD, afatet e parashikuara në asnjërin prej akteve sipërcituar¹⁵, duke cënuar kështu të drejtën e tij për mbrojtje efektive sipas afateve kohore të mirëpërcaktuara. Nga ana tjetër, po në shkelje të dispozitave të këtyre akteve, ankuesit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument provues që të justifikonte masën disiplinore “Për largimin nga puna të tij”, lidhur me sa pretendonte DPD.

Nëpërmjet shkresës me nr.18101 prot., datë 11.07.2019 Drejtori i Antikontrabandës, ka njoftuar “Për fillim procedure administrative”, vetë punonjës E. P dhe Komisionin Disiplinor, ku fton ankuesin që brenda 5 (pesë) ditëve mund të paraqesë observacion me shkrim, lidhur me

¹⁵ Dy nga ditët janë: e shtunë, e diel.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

informacionin e marrë nga Sektori i Monitorimit se me datë 02.07.2019 z.P nuk ishte prezent në Degën e Doganës Fier në orën 15:46 dhe nuk raportoi për vendndodhjen e tij deri në orën 16:00.

Nëpërmjet shkresës me nr.18101/1 prot., datë 17.07.2019 Kryetari i KD ka njoftuar ankuesin për zhvillimin e seancës dëgjimore “Për fillimin e procedurës administrative” lidhur me shkeljen e pretenduar të z.P.

Nëpërmjet shkresës me nr.18101/3 prot., datë 30.07.2019 “Propozim mase disiplinore nga Komisioni Disiplinor”, KD i ka propozuar titullarit të DPD, në tagrin e punëdhënësit me ankuesin “*ta largojë atë nga puna*”.

Referuar përmbajtjes së kësaj shkrese, tek pjesa “Rrethanat e çështjes”, evidentohen faktet, si më poshtë:

- Z.P i është komunikuar se ecuria disiplinore për të është iniciuar lidhur me mosprezencën e tij në vendin e punës me datë 02.07.2019 nga ora 15:46-16:00.
- Z.P ka dhënë shpjegimet e veta lidhur me mosprezencën në vendin e punës në orarin e cituar për shkak të arsyeve shëndetësore të tij, duke paraqitur dhe raportin mjeko-ligjor të mjekut të SUT me nr.regj.300, datë 02.07.2019, sipas të cilit atij i jepej 3 (tre) ditë pushim.
- Nga ana e KD ky raport mjeko-ligjor as nuk është vënë në dyshim lidhur me vërtetësinë e tij dhe as nuk është pranuar si justifikim i ligjshëm dhe objektiv nga ana e tyre.
- Ankuesi ka cituar se megjithëse kishte raport mjekësor edhe për dy ditët në vijim ai ka dalë në punë, pikërisht për të mos penguar realizimin e objektivave të punës, të grupit të tij.
- KD lidhur me mosprezencën e ankuesit në vendin e punës, herë i referohet citimit të bazës ligjore të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; herë asaj të Kodit të Punës, duke treguar paqartësi dhe vetëkundërshti sa i takon referencave ligjore.
- Ndër të tjera¹⁶, citohet se “*sipas konfirmimit të Dejtorisë së Burimeve Njerëzore, në dosjen personale të z.E. P, ka një masë disiplinore “Vërejtje për mungesë në detyrë”*”.
- Lidhur me këtë citim të KD, i cili i ka shërbyer atij për ta refruar mungesën në detyrë të ankuesit si shkelje të përsëritur, Komisioneri konstaton se:

Së pari, nuk specifikohet cila është konkretisht “Vërejtja”, data kur është marrë, shkak, arsyeja apo procedura e ndjekur për dhënien e saj.

Së dyti, ankuesi nuk ka qenë në dijeni të saj, as më përpara datës së seancës dëgjimore, dhe as në momentin e shqyrtimit të pretendimit të njoftuar paraprakisht nga KD gjatë seancës, pasi ai ishte njoftuar për të paraqitur observacione lidhur me mungesën në vendin e punës me datë 02.07.2019. Rrjedhimisht nuk kishte as si të mbrohej ndaj një mase të panjohur prej tij.

KD duke qenë pjesë e DPD në procedurën e ndjekur lidhur me ecurinë disiplinore ndaj ankuesit duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punonjësit duhet t’i ishin krijuar mundësitë për t’u mbrojtur efektivisht. Shkelja e këtij parimi përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e

¹⁶ Në faqen 4, të shkresës së KD.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu në vendimin nr.69 dt.16.10.2000 të Gjykatës Kushtetuese thuhet: *“Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”*.

Ky parim u siguron palëve kushte e mundësi të barabarta për të përdorur mjetet në mbështetje të pretendimeve të tyre me faktet e provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t’u referohen¹⁷.

Zbatimi i parimit të kontradiktoritetit duhet pasqyrohej edhe në vendimin e KD (dhe në vijim dhe të punëdhënësit), pasi në kushtet kur nuk respektohet ky parim nuk mund të ketë gjykim të mirfilltë, dhe as proces të rregullt ligjor.

Së treti, Komisioneri vlerëson të pabazuar dhe të pa provuar argumentimin e KD për shkelje të përsëritur të ankuesit, bazuar pikërisht në citimin se ai “kishte dhe një vërjetje tjetër për mungesë pa arsye në vendin e punës”.

Së katërti, Komisioneri vlerëson të theksojë si të rëndësishëm një fakt të evidentuar në komunikimin mes ankuesit dhe Sektorit të Monitorimit përmes aplikacionit të WhatsApp, bazuar në të cilin ankuesit i është dërguar në orën 16:11 mesazhi me përmbajtjen: “Në orën 16:00 konfirmoni prezencën tuaj dhe të grupit përpara kamerave në degën doganore ku ndodhëni”. Qartazi kjo kërkesë është alogjike dhe krijon dyshimin e arsyeshem se është dhe tendencioze ndaj ankuesit.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar në nenin 80¹⁸, pika 1, germa a) e tij ka përcaktuar se: *“Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: ...të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike”*. Bazuar në sa mësipër, Komisioneri ka vlerësuar në cilësi prove dhe komunikimet e dokumentuara/përmes aplikacionit WhatsApp, të sjella nga ankuesi, mes tij dhe Sektorit të Monitorimit.

Referuar vendimit nr.13627/1 prot., datë 14.06.2019 të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, “Për lirim nga shërbimi civil”, z.P, si dhe kontratës individuale të punës¹⁹, subjekti ankues duhej trajtuar me legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës, bazuar në Kodin e Punës, të ndryshuar. Kështu, neni 13 i Kontratës Individuale të punës “Masat disiplinore”, ka cituar se cilat konsiderohen shkelje të lehta të disiplinës dhe cilat shkelje të rënda, duke mirëpërcaktuar se:

- Konsiderohen shkelje të lehta të disiplinës:
 - a) Moszbatimi i orarit të punës me 30 minuta në ditë;
 - b) Mungesa në punë një ditë;
 - c) Largimi pa leje nga vendi i punës për periudha të shkurtra;

¹⁷ Neni 6.1 i KEDNJ.

¹⁸ Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të provës.

¹⁹ Shkresa me nr.13627 prot., datë 31.05.2019 “Kontratë individuale pune”.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

d) Sjellja jo korrekte me kolegët, eprorët dhe të tretët gjatë orarit të punës dhe jo të përsëritura.

- Konsiderohen shkelje të rënda të disiplinës:

a) Moszbatimi i përsëritur i orarit të punës me 30 minuta në ditë;

b) Mungesat e përsëritura të pajustificuara në punë deri në tre raste, me gjithë paralajmërimet e herëpsherëshme të punëdhënësit;

c) Shkaktimi i dëmit material me dashje ose nga pakujdesia;

d) Shkelje e detyrimeve të përcaktuara në pikat 3,6,7,8,9,10 dhe 11 të nenit 9, të kësaj kontrate;

e) Shkelje të përsëritura të detyrimeve të përcaktuara në nenet e kësaj kontrate.

Pra, në kontekst të sa më sipër, subjekti ankues nuk plotësontë asnjë nga kushtet e përcaktuara për marrjen e masës disiplinore të cilësuar si “shkelje të rëndë”.

Në këto kushte dhe në logjikën e argumentimit më lart, Komisioneri vlerëson se, Vendimi “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës” me ankuesin nga ana e DPD, referuar pikërisht mbi referimin e KD²⁰ është i paligjshëm dhe i pabazuar në prova dhe fakte.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Nga ana e DPD nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin të kishte ardhur për arsye të ligjshme apo të ishte e arsyeshëm, proporcionale dhe e justifikuar.

DPD jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm, por shpjegimet e dhëna prej saj, janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Neni 14, i Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar , lidhur me parimin e objektivitetit ka parashikuar se: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

²⁰ Shkresa me nr.18101/3 prot., datë 30.07.2019 e KD.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se i është nështruar një trajtimi të pabarabartë dhe diskriminues sa i takon detyrimin të grupit të tij (dhe atij personalisht) për të raportuar disa herë në ditë, apo kërkimit të fotove në çdo rast, për të gjithë grupin, ndryshe nga grupet e tjera të antikontrabandës, Komisioneri, nga këqyrja dhe verifikimi i dokumentacionit të sjellë nga DPD, ka konstatuar se një kërkesë e tillë është aplikuar për të gjitha grupet e antikontrabandës dhe komandantët e tyre dhe jo vetëm për ankuesin dhe grupin e tij. Pra, sa i takon këtij pretendimi të ankuesit, ai nuk qëndron dhe është i pabazuar, përsa kohë në të njëjtën mënyrë janë trajtuar të gjitha grupet (dhe komandantët e tyre) e antikontrabandës.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2²¹, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të:

“gjendjes ekonomike”,

“përgjegjësisë prindërore”,

“gjendjes familjare”,

“gjendjes martesore” dhe “çdo shkak tjetër”,

Komisioneri vlerëson se ato konsiderohen si shkaqe të mbrojtura, pasi parashikohen si të tillë në LMD, por subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se mbart vetëm dy prej këtyre shkaqeve:

²¹ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

- Referuar Vendimit nr.5661, datë 08.07.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, provohet se ankuesi ka përgjegjësi prindërore, të drejta dhe detyrime respektive ndaj fëmijës së tij minore S.P, i cili i është lënë për rritje dhe edukim M.M.
- Po ashtu, ushtimin e kësaj përgjegjësie ankuesi e ka provuar edhe nëpërmjet dokumentimit të pagesave të realizuara prej tij për fëmijën e vet, i cili prej disa vitesh jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- Po ashtu rezulton e provuar/dokumentuar se është i divorcuar dhe kryefamiljar i vetëm.

Sa i takon pretendimit për diskriminim për shkak “të gjendjes ekonomike”, me arsyetimin se largimi nga puna ka përkeqësuar gjendjen e tij ekonomike, Komisioneri vlerëson se, ajo ka ardhur si pasojë e largimit të tij nga puna por nuk është shkak në vetvehte.

Sa i takon pretendimit të tij për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, pa asnjë argumentim apo sqarim rreth tij, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkak” në vetvehte.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh²². Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh²³.

Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

²² Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

²³ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Diskriminimi²⁴ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta identifikonte dhe provonte se e posedonte atë.

A. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DPD duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”²⁵ dhe trajtimit të paligjshëm apo të padrejtë të ankuesit.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës²⁶, Komisioneri vlerëson se z.P i është nënshtruar një qëndrimi të paligjshëm e të padrejtë nga ana e DPD. Por, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, ankuesi nuk arriti të provojë dhe dokumentojë se shkaqet e pretenduara prej tij kanë shërbyer si shkaqe për të cilat ai është diskriminuar nga ana e DPD.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të faktit se subjekti ankues i është nënshtruar trajtimit të padrejtë e të paligjshëm nga ana e DPD, nuk u arrit të provohej se masat disiplinore dhe largimi përfundimtar nga puna i tij kanë ardhur pikërisht për shkaqet e pretenduara prej tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

²⁴ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

²⁵ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

²⁶ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z.E. P, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaqet: “Gjendja ekonomike”, “përgjegjësia prindërore”, “gjendja familjare”, “gjendja martesore” dhe “çdo shkak tjetër”.